

KLSH merr pjesë në Seminarin On-line të zhvilluar nga EUROSAT ITWG

“Save the date”.

19 Prill 2023

Në datën 19 Prill 2023 u zhvillua takimi i Grupit të Punës së EUROSAT-t për Auditimet IT ITWG, me temë “Save the date”. Ky takim, i organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Estonisë, u zhvillua në formatin on-line me përfaqësues të 80 Institucioneve Supreme të Auditimit nga e gjithë bota.

Kontrolli i Lartë i Shtetit si një prej anëtarëve të këtij grupi pune, u përfaqësua në këtë takim nga z. Rodjan Alimerkaj, auditues IT në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit.



Tematikat e trajtuara gjatë këtij seminari ishin si më poshtë vijon:

- Vlerësimi i ndikimit EIDAS 2.0 në nivelin e shtetit anëtar dhe bashkimit në ekosistemet dixhitale;
- e-Government dhe eID – perspektiva e audituesit: Raporti Special i ECA-s nr. 24/2022;
- Përvojë nga rajoni ARABOSAT;
- Identiteti dhe verifikimi dixhital – mësimet nga MB;
- Shërbimet e Qeverisjes elektronike – vlerë e shtuar për qytetarët dhe qeverinë;
- Lindja e egër përpara eIDAS – rishikim i programit të e-rezidencës së Estonisë;
- Agjencitë qeveritare Suedeze dhe shërbimi dixhital – si të ofrohet shërbim për individët që nuk mund ose nuk duan të jenë dixhital;

Gjatë këtij seminari u paraqitën edhe prezantime nga partnerë të ndryshëm të ITWG pranë INTOSAT-t, në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit mbi auditimin e teknologjisë së informacionit. Grupi i punës së Teknologjisë së Informacionit pranë EUROSAT-t është krijuar në vitin 2002 me qëllim ofrimin e mundësisë për Institucionet Supreme të Auditimit të ndajnë eksperiencat në lidhje me auditimin IT dhe rritjen e bashkëpunimit në këtë fushë. Që prej qershorit të vitit 2020, kryesimi i këtij grupi pune mbahet nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Estonisë.